



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 13790/3 prot.

Lezhë, më: 14.11. 2025

NJOFTIM

**“PËR ORGANIZIMIN E DËGJESËS PUBLIKE PËR
DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË FONDIT PYJOR
KOMBËTAR, SHOQËRISË ONE ALBANIA SHA, PËR ANTENAT E TELEFONISË
CELULARE, FSHATI BALLDRE, NJËSIA ADMINISTRATIVE BALLDRE DHE
FSHATI MABË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DAJÇ, BASHKIA LEZHË**

Bashkia Lezhë, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqëverisjen vendore”, në ligjin Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, në VKM-në 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, në ligjin 57/2020 “Për Pyjet”, si dhe në Projekt Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Lezhë nr. 13790 prot, datë 14.11. 2025 “Për Dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar me kontratë qiraje për antenën e telefonisë celulare me kod LE1004 shoqërisë **ONE ALBANIA SHA**, në fshatin Balldre, Njësia Administrative Balldre, Bashkia Lezhë, si dhe Dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar me kontratë qiraje për antenën e telefonisë celulare me kod SH2006, shoqërisë **ONE ALBANIA SHA**, në fshatin Mabë, Njësia Administrative Dajç, Bashkia Lezhë, organizon dëgjuesën publike për informimin e komunitetit dhe grupeve të interesit, lidhur me dhënien në përdorim të sipërfaqeve pyjore të kërkuara nga shoqëria **ONE ALBANIA SHA**.

Në vijim të procesit të konsultimit me publikun, ju ftojmë të merrni pjesë në dëgjuesën publike, ditën e enjte, datë 18.12.2025, ora **11:00**, në sallën e Bibliotekës “Gjergj Fishta” Lezhë.

Gjatë takimit të dëgjuesës publike do bëhet prezantimi i dokumentacionit lidhur me kërkesën për dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar shoqërisë **ONE ALBANIA SHA**.

Ju mirëpresim për të ndarë mendimet tuaja!

KRYETARI

Pjerin NDREU

